



Dt. 16.09.2025

Nr. 2378/3 Prot

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 574/3
prot

Shkoder, më 16.09.2025

LËNDA: Mbi Vendimin e Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe Nr.30, datë 03.09.2025.

KËSHILLIT BASHKIAK MALËSI E MADHE

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107, datë. 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 18, 24, neni 54 germa k, neni 55/2, ligj nr.9970/2008 "Për barazinë gjinore", ligjit Nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH" neni 36 pika 1/c, VKM Nr.111/2018 "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social", dokumentacionit të sekretarit të KB, shkresës nr.2562 prot date 15.09.2025, shqyrtoi Vendimin e Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe Nr.30, datë 03.09.2025 "Mbi miratimin e planit social vendor për periudhën 2025-2027".

Prefekti konstaton se në mbështetje të ligjit Nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" neni 36 pika 1/c, Këshilli Bashkiak ka tagrin të miratojë një plan social vendor¹.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI



¹ Sipas propozimit të organit ekzekutiv